



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 15.09.2008 ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N.225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Vlora Çitaku, Fatmire Berisha, Memli Krasniqi, Adem Hajdaraj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Hestet Cakolli.

Munguan: Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Arkivit të Kosovës Jusuf Osmani dhe Gazmend Berisha.

Pjesëmarrës tjerë në mbledhje ishin përfaqësues të KDI-së, përfaqësues të OSBE-së , dhe përfaqësuesi nga Presidenca e Kosovës.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshim e Plotësimin e Ligjit mbi Arkivat dhe Lëndën Arkivore.**
- 3. Shqyrtimi i shkresës së Institutit të Historisë.**
- 4. Shqyrtimi i shkresës së Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 17.07.2008 pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshim e plotësim të Ligjit mbi Arkivat dhe Lëndën Arkivore

Kryesuesi theksoi se Komisioni ka caktuar raportuesen për këtë Projektligj deputeten Donika Kadaj Bujupi.

Donika Kadaj- Bujupi konsideron se nuk duhet bërë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Lëndën Arkivore dhe Arkivat me të cilin parashihet ndryshimi i pozitës së statusit të Arkivit nga Departamenti në Agjencion.

Sipas këtij projektligji me ndryshimin e pozitës së Arkivit nga Departamenti në Agjencion Shtetëror do të mundësohej ndërhyrja e politikës në arkiva dhe se kjo do të ketë ndikim negativ.

Ajo konsideron se niveli i Drejtoratit duhet të rregullohet dhe mbetet ashtu siç është trashëgimi kulturore jashtë qëndrimit politik.

Me tej theksoi edhe shembullin e Agjencionit të Brazisë Gjimore që është në kuadër të Qeverisë si Agjencion jo funksional të ndikuar nga politika.

Jusuf Osmani drejtor i Arkivit të Kosovës, shpjegoi arsyet e ndryshimit të pozitës së Arkivit dhe Lëndëve Arkivore si segment të rëndësishëm në një vend.

Ndryshimi i pozitës së Arkivit nga Drejtorati në Agjencion Shtetëror është dashur të bëhet me qëllim të lidhjes së drejtëpërdrejtë me Qeverinë gjë që do të ndikonte në krijimin e marrëdhënjëve të drejtëpërdrejta dhe bashkëpunimin me shtetet e rajonit në këtë fushë.

Statusi shtetëror për Lëndët Arkivore dhe Arkivat ekziston në vendet e ndryshme të rajonit, dhe si i tillë do duhej të përcaktohet me ligj edhe për vendin tonë..

Gazmend Berisha, nga Arkivi i Kosovës shpjegoi se mënyra e vetme e realizimit të marrëveshjeve me shtetet në rajon mund të bëhet vetëm me ndryshimin e pozitës së Arkivit si Institucion shtetëror në kuadër të Qeverisë.

Agim Veliu konsideron se duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i strukturës së arkivit nga Drejtorati në Agjencion.

Drita Kadriu konsideron se do duhej të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i strukturës së arkivit pavarësisht pozicioneve dhe bindjeve politike.

Memli Krasniqi mendon se dilema e shfaqur e politizimit të arkivave mund të bëhet edhe me statusin aktual të arkivave dhe se ndikimi politik do të jetë më i ulët me ndryshimin e strukturës së pozitës së Arkivit nga Drejtoria në Agjencion Shtetëror.

Ai nuk pajtohet me atë që arkivat janë trashëgimi kulturore, dhe vlerëson se dokumentacioni që ruhet në arkiv ka karakter shtetëror e që do duhej të bëhej plotësimi dhe ndryshimi i këtij Projektligji.

Enis Kervan theksoi se në shtetet e rajonit, ndryshon edhe struktura e arkivit. Ky ndryshim i pozitës së arkivit sipas tij është i natyrës teknike dhe se pajtohet me ndryshimin dhe plotësimin e pozitës së arkivit nga pozita e Departamentit në atë të Agjencionit Shtetëror.

Vlora Çitaku konsideron se ngritja e çështjes së Arkivit në Agjencion Shtetëror do duhej të bëhet me qëllim të krijimit të partneritetit me shtetet tjera.

Heset Cakolli theksoi se pavarësisht nga dilemat politike do duhej arkivat ta kenë autonominë e tyre, dhe duhet bërë ndryshimi i pozitës së arkivave në të mirë të Institucioneve të Kosovës.

Fatmire Berisha tha se arkivat do duhet ta kenë vendin e merituar në çdo vend, dhe se është për ndryshim dhe plotësim të pozitës së arkivit në të mirë të tyre.

Donika Kadaj Bujupi konsideron se qëndrimi i saj për mos ndryshimin e pozitës së arkivit është i drejtë dhe lidhur me këtë mendon se duhet pasur trajtim të veçantë edhe zgjedhja e kryeshefit të Agjencionit.

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për Ndryshimin e Plotësimin të Ligjit mbi Lëndën Arkivore dhe Arkivat dhe ka miratuar me shumicë votash këto amendamente:

Amendamenti 1

Preambula riformulohet :

“ **Kuvendi Republikës së Kosovës**

Në bazë të nenit 65.1 dhe 80.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullativës ligjore përkitazi me veprimtarinë, aktivitetet dhe funksionimin institucional për Lëndën Arkivore dhe Arkivat, Miraton

Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 2003/7, për Lëndën Arkivore dhe Arkivat.

Amendamenti 2

Në tërë tekstin e Projektligjit fjalët “**Drejtori i Arkivit të Kosovës**” zëvendësohen me fjalët “**Agjencia Shtetërore e Arkivave**”

Amendamenti 3

Nenit 2. të Ligjit për Lëndën Arkivore dhe Arkiva i shtohet titulli:
“**Agjencia Shtetërore e Arkivave**”.

Amendamenti 4

Neni 2.1, riformulohet:

2.1 “Me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive të përcaktuara me këtë ligj Drejtoria e Arkivave shndërrohet në Agjenci Shtetërore të Arkivave si institucion qendror në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës – Zyrës së Kryeministrit, i cili organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë në të gjithë rrjetin arkivor të vendit’.

Amendamenti 5

Neni 2.2, riformulohet:

2.2 “Agjencia Shtetërore e Arkivave” të Kosovës është person juridik, ka vulën me stemën e Republikës së Kosovës dhe emërtimin e vet. Aktivitetet e Agjencisë do të udhëhiqen nga Kryeshefi i Agjencisë, i cili i raporton dhe i përgjigjet Kryeministrit.

Neni 2.2 i Ligjit bëhet paragrafi 2.3 e kështu me radhë.

Amendamenti 6

Në nenin 20 të Ligjit, pas paragrafit 20.2 shtohet një pikë e re:

20.2.1 Agjencia Shtetërore e Arkivave

Neni 20.2.1. të Ligjit fjalët ‘Arkivi i Kosovës’ zëvendësohet me fjalën ‘Arkivi Shtetëror i Kosovës’ dhe merr numrin 20.2.2. e kështu me radhë.

Amendamenti 7

Neni 24.1 fshihet.

Amendamenti 8

Neni 44.3. të Ligjit, në rreshtin e dytë fjalët “mund të japë urdhër apo udhëzim administrativ” zëvendësohet me fjalët “mund të japë urdhër apo udhëzim profesional”.

Amendamenti 9

Neni 49 të Ligjit riformulohet:

‘Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës’

Kundër ndryshimit dhe plotësimit të këtij projektligji ishte referuesja **Donika Kadaj Bujupi**.

3. Shqyrtimi i shkresës së Institutit të Historisë.

Kryesuesi Agim Veliu i njoftoi anëtarët e Komisionit me përmbajtjen e shkresës së Institutit të Historisë si dhe hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Adem Hajdaraj theksoi se lidhur me këtë çështje është informuar nga mjetet e informimit dhe konsideron se mënyra e tillë e tjetërsimit të pronës nuk është e drejtë me këtë rast ai përkrah kërkesën e Institutit të Historisë.

Donika Kadaj Bujupi konsideron se Vendimi i Qeverisë për marrjen e objektit të Institutit të Historisë për nevojat e Bibliotekës është i veprim i ngutshëm dhe jo i drejtë, andaj propozon që Komisioni të merr një qëndrim lidhur me këtë çështje.

Vlora Çitaku thekson se Vendimi i Qeverisë nuk ka për qëllim mbylljen e Institutit, me këtë rast Qeveria ka vendosur që objekti i Institutit të Historisë të ridestinohet për nevojat e Bibliotekës Universitare, ndërkaq objekti i Institutit të kalojë në një objekt tjetër për të cilën duhet gjetur zgjedhje.

Memli Krasniqi konsideron se Vendimi i Qeverisë është i drejtë dhe si i tillë rezulton nga Vendimi i Universitetit të Prishtinës. Ai gjithashtu konsideron se kërkesa e Universitetit është legjitime ngase dihet numri i studentëve të Universitetit të cilët janë jashtë nivelit të studimit dhe mësimi, andaj thekson se Institutit nuk i është mbyllur destinimi por vetëm i është ndërruar adresa në lokalet e Akademisë së Shkencave të Kosovës.

Heset Cakolli mendon se ndërrimi i destinimit të Objektivit të Institutit është një vendim i ngutshëm i Qeverisë dhe konsideron se Instituti i Historisë duhet të mbetet në të njëjtin objekt për të cilin edhe janë dedikuar mjetet.

Agim Veliu thekson se themelimi i Institutit të Historisë parashihet me nenin 11 të Ligjit për Veprimtaritë Kërkimore Shkencore ku thuhet Institutet i themelon se Kuvendi i Kosovës. Objekti i Institutit të Historisë ka filluar të ndërtohet me mjetet e Qeverisë për nevojat e veta, andaj konsideron se vendimi i Qeverisë për tjetërsimin e objektit të Institutit është i paligjshëm dhe si i tillë duhet të rishikohet nga ana e Qeverisë.

Kryesuesi, pas debatit lidhur me shkresën e Institutit të Historisë propozoi që Komisioni t'i rekomandon Qeverisë rishikim të Vendimit për Institutin e Historisë.

Komisioni me shumicë votash, dy kundër dhe një abstenim vendosi që Qeverisë t'ia paraqet këtë :

R e k o m a n d i m

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport vlerëson se Vendimi i Qeverisë së Kosovës, për dhënjen në shfrytëzim të objektit të Institutit të Historisë për nevojat e Bibliotekës Kombëtare Universitare është vendim i ngutshëm dhe rekomandon që i njëjti të rishqyrtohet.

4. Shqyrtimi i shkresës së Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me kërkesën e Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, për mbajtjen e një seance dëgjimore lidhur me procesin e akreditimit të Institucioneve të arsimit të lartë.

Komisioni lidhur me këtë ka kërkuar nga ministria informacionet e sakta – analizën e Raportit të Ministrisë lidhur me procesin e akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, Vendimin e Qeverisë lidhur me procesin e akreditimit të bartësve të arsimit privat si dhe Raportin e Këshillit Britanik për Akreditim.

Anëtarët e Komisionit shprehën shqetësimin lidhur me shkresat e kërkuara nga Ministria dhe kërkuan sqarim pse nuk janë dërguar të njetat.

Komisioni gjithashtu ka shprehë papajtueshmërinë me vendimin e Ministrit të Arsimit, për zbritjen e pragut të kalueshmërisë sipas Ligjit për Maturën Shtetërore nga 50% në 45%, dhe lidhur me këtë ka kërkuar sqarim të cilin nuk e ka marrë.

Anëtarët e Komisionit kërkuan që përsëri t'i parashtrohet kërkesë Ministrisë së arsimit për procedimin shkresave lidhur me procesin e akreditimit të bartësve të arsimit privat, si dhe për këtë çështje të njoftohet edhe Kryesia dhe kryetari i Kuvendit.

Komisioni vendosi që pas sigurimit të materialit të nevojshëm për këto çështje të ftojë Ministrin e arsimit dhe të debatojë lidhur më çështjet e arsimit në njerën nga mbledhjet e ardhshme.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15,10.

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryesuesi i Komisionit,
Agim Veliu**